



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS V...

Numri i lëndës: 2022:108028

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06075742

P.nr.188/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.Sh, nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me nenin 1 nen par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.661/2020 të datës 26.05.2022, e plotësuar nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, i datës 20.08.2024, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarës Sh.Sh, përfaqësuesit me autorizim av.K.F., të pandehurit L.SH. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.R.M., pas shpalljes së aktgjykimit më datë 20.08.2024, më datë 22.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.Sh nga i ati H..., e ëma B..., e vajzërisë H..., data e lindjes... në Vushtrri, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, beqar, punon si frizer, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 09.05.2020, në fshatin Bukosh komuna e Vushtrrisë, me dashje dhe me përdorim të forcës fizike i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, dhe atë ish bashkëshortes këtu të dëmtuarës Sh.Sh, e cila është viktimë e ndjeshme për shkak të shtatzënisë, në atë mënyrë që, në ditën kritike për shkak të një mosmarrëveshje, i pandehuri në shenjë revolte e godet të dëmtuarën ku si pasojë kjo e fundit pëson ndrydhje dhe mavijosje në të dy anët e qafës, në anën e djathtë të abdomenit dhe në parakrahun e dorës së djathtë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me nenin 1 nen par.1.4 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 185

të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

TË PANDEHURIT: L.Sh i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar Sh.Sh për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 661/2020 të datës 26.05.2022, kundër të pandehurit L.Sh, nga komuna e Vushtrrisë , për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me nenin 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm fillimisht ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 661/2020 të datës 26.05.2022, kundër të pandehurit L.Sh, nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës Dhuna në familje nga neni 248 par.3 dhe par.1 të KPRK-së, të cilën në seancën e shqyrtimit gjyqësor 20.08.2024 e ka plotësuar, pas pranimin të akt ekspertimit të dytë në drejtim të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me nenin 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

### *Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 20.08.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit dhe plotësimit të dispozitivit të aktakuzës dhe kualifikimit ligjor, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri L.Sh ka deklaruar se edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor 03.02.2023 e ka pranuar fajësinë e po ashtu edhe sot e pranon fajësinë sipas rikualifikimit të bërë nga prokurori i shtetit, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëritet më vepra të ngjashme penale, po ashtu deklaron se me të dëmtuarën janë ndarë dhe nuk kanë ndonjë kontakt. Ndërsa në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se e mbështet në tersi fjalën e avokatit mbrojtës.

*Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit, pasi që si i tille ky deklaram i tij është bërë pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe pas njoftimit për favorret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si i tille po ashtu gjene mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës e që janë prova të ligjshme të marra në bazë të kompetencave ligjore të prokurorit të shtetit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh që i pandehuri është deklaruar fajtor për këtë veprë penale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të i ketë parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë të bërë në një fazë të hershme të procedurës nga ana e të pandehurit, keqardhjen e shprehur për veprën, si dhe faktin se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale respektivisht aktgjykime të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret fakti se kjo veprë penale është kryer brenda marrëdhënies familjes çka si e tillë kjo rrethanë nuk mund të merret parasysh në kualifikim ligjore të veprës penale por që gjithsesi duhet të merret si rrethanë rënduese ashtu siç është paraparë edhe në KPRK, rrethanë tjetër rënduese të merret parasysh shkalla e lartë e dashjes në veprimet e të pandehurit për faktin se e njëjta nuk ka pësuar goditje vetëm në një pjesë të trupit por ka pësuar lëndime në qafë, në abdomen si dhe në dorën e djathtë, çka si të tilla p.sh nuk mundet ta ngarkoj të pandehurin me tre vepra të posaçme penale, por që kjo duhet marrë si rrethanë rënduese e shtuar këtu edhe faktin se e dëmtuara për shkak të gjendjes së saj fizike e ka pasur të pamundur që në ndonjë mënyrë të mbrohet nga goditjet e të njëjtit.

E dëmtuara lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar e përkrah fjalën e prokurores së shtetit dhe kërkon kompensimin e dëmit lidhur me këtë çështje penale. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe shton që të merren parasysh gjendja psikike në kohën kur ka ndodhur rasti, gjatë kohës sa kemi qenë duke bashkëjetuar dhe kohës pasi që jemi ndarë.

Përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit dhe i kërkon gjykatës që ta pranoj fajësinë nga ana e të pandehurit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit si dhe i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të i ketë parasysh të gjitha rrethanat rënduese të rastit.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimeve me të mbrojturin e tij në këtë seancë i njëjti në mënyrë vullnetare dhe pa imponime e pranon në tërësi veprën penale për të cilën ngarkohet nga prokuroria e shtetit, dhe i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i pandehuri e ka pranuar në tërësi veprën penale për të cilën ngarkohet, për këtë veprë është penduar thellë dhe i premtom gjykatës që në të ardhmen nuk do të bije asnjëherë ndesh me ligjin, gjithashtu me rastin e shqiptimit të dënimit të mbrojturit të tij, të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si që nga momenti i kryerjes së veprës penale 2021 e gjerë më sot asnjëherë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin dhe për veprën penale për të cilën ngarkohet të dëmtuarës i kërkon falje si dhe gjykatës, ashtu që me një dënim sa më të ulët do të arrihej qëllimi

i dënimit, ashtu që i mbrojturi i tij të mos kryej vepër penale në të ardhmen.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit, i datës 04.06.2020, raporti i shpejtë, i datës 04.06.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të viktimës- dëshmitares Sh.Sh, i datës 04.06.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit L.Sh, i datës 04.06.2020, fotoalbumi në shtojcë prej 8 fotove, procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit, i datës 22.03.2021, akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes, i datës 14.11.2020.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 185, par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së është përcaktuar se “Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëri nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me: burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni” ndërsa në nenin 1 nënpar.1.4 është përcaktuar se “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër, si dhe faktin se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të dashjes, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si

dhe faktin se kjo veprë penale është kryer brenda familjes dhe vetë ligji e parasheh si rrethanë rënduese.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës*

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*, ashtu që në rastin konkret në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.08.2024 pala e dëmtuar ka kërkuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.188/22, datë 22.08.2024

**GJYQTARI**  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit

Numri i lëndës: 2022:108028  
Datë: 22.08.2024  
Numri i dokumentit: 06075742

në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit.  
Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.